



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2019:080032

Datë: 21.06.2019

Numri i dokumentit: 00370960

P.nr. 78/2019

GJYKATA THEMELORE PEJË DEGA NË DEÇAN, gjyqtari Sulltan Dobraj, e me pjesëmarrjen e sekretares juridike Sabiha Hoxha, ne lëndën penale kundër të pandehurit A.P. i akuzuar sipas PTH nga Peja me aktakuzë PP/II.nr.379/2019 të dt.25.02.2019, për vepër penale lidhje e pa autorizuar në shërbime nga neni 321 par.1.te KPRK-ës, në shqyrtimin gjyqësore me dt. **30.04.2019**, konform nenit 358 te KPPK-ës, jashtë seancës gjyqësore ka pruar këtë :

A K T V E N D I M

HUDHET AKTAKUZA PP/II.nr.379/2019 të dt.25.02.2019, kundër A.P. për vepër penale lidhje e pa autorizuar në shërbime nga neni 321 par.1.të KPRK-ës, **dhe PUSHOHET** procedura penale në çështjen penale **P.nr. 78/2019** kundër A.P. për veprën penale lidhje e pa autorizuar në shërbime nga neni 321 par.1.te KPRK-ës.

për shkak se:

prokurori i shtetit ka tërhequr Aktakuzën PP/II.nr.379/2019 të dt.25.02.2019 dhe ka hequr dorë nga ndjekja penale.

E dëmtuara 'K...' për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest civil.

Shpenzimet procedurale penale bijnë në barrë te mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

PTH nga Peja me aktakuzën **PP/II.379/2019 të dt.25.02.2019** ka akuzuar të pandehurin A. P. për vepër penale lidhje e pa autorizuar në shërbime nga neni 321 par.1.te KPRK-ës, ka propozuar të caktohet dhe të mbahet seanca e shqyrtimit gjyqësor për këtë çështje penale.

Gjykata themelore ne Pejë Dega ne Deçan me dt. **30.04.2019**, ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar ku pas mbajtjes se shqyrtimit fillestar i pandehuri ka paraqitur kërkesë për shpalljen e provave te papranueshme dhe kërkesë për hedhje te aktakuzës.

Prokurori pas deklarimit se i pandehuri ka paguar në tërësi vlerën e caktuar prej 241.16 euro, konform nenit 292 të KPKRK-së heqë dorë nga ndjekja penale, dhe e ka tërhequr aktakuzën PP/II.379/2019 të dt.25.02.2019, dhe ka hequr dore nga ndjekja penale kundër te pandehurit A. Pepa.

Me që nëse prokuroria e shtetit ka hequr dore nga aktakuza, ne baze te nenit 463 te KPPK gjykata e ka udhëzuar te dëmtuarën 'K...' ne kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

Gjykata në bazë të nenit 454 të KPPK ka vendosur që shpenzimet e procedurës penale të bien barre e mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

Gjykata duke u bazuar në nenin 358 par.2 lidhur me nenin 81 te KPPK- së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMUNALE NE DEÇAN,
P.nr.78/2019 te dt.23.05.2019.**

**Sekretare juridike,
Sabiha Hoxha**

**G J Y Q T A R I
Sulltan Dobraj**

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 3 ditësh kolegjit penal të kësaj gjykate pas marrjes së të njëjtës.

Numri i lëndës: 2019:080032
Datë: 21.06.2019
Numri i dokumentit: 00370960